



BULETINI ZYRTAR I KOMUNËS SË DOLLNENIT

Buletini zyrtar i komunës së Dollnenit del sipas nevojës	15.09. 2014 Numër 10, viti 2014 DOLLNEN	xhiro-llog. 300020000212077 NT 6021067000004 Tel: 048/453-210
--	---	---

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 5/02) dhe neni 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini zyrtar i komunës së Dollnenit" nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë :

K O N K L U Z Ë

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të detyrave të administratës komunale në komunën e Dollnenit –Dollnen

1. Shpallet vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të detyrave të administratës komunale në komunën e Dollnenit –Dollnen me nr. 07-1141/2 i sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më 15.08.2014.

2. Konkluzo do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-1501/1
15.09.2014

Prefekti
D-r Boshe Millosheski
Dollnen

Në bazë të nenit 57, paragrafi 4 nga Ligji për Vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 5/2002) dhe neni 70, paragrafi 1, alineja 3 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini zyrtar i komunës së Dollnenit", nr. 08/05) Këshilli i komunës së Dollnenit në seancën e tij të njëzetënjë e mbajtur më 15.08.2014 e solli këtë:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të detyrave të administratës komunale në komunën e Dollnenit –Dollnen

Neni 1

Në neni 6, paragrafi 1 nga Vendimi për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të detyrave të administratës komunale në komunën e Dollnenit –Dollnen me nr. 07-150/8 nga 27.01.2014 shlyhet alineja 1.

Neni 2

Në neni 6, paragrafi 1 para alinesë 2 shtohen dy alineja si vijojnë:

1. **Departamenti për çështje të përgjithshme dhe juridiko-normative.**
2. **Departamenti për veprimtari publike.**

Në neni 6, paragrafi 1 bëhet ndryshimi i radhës së alineve edhe atë: alineja me numër 2 bëhet aline me nr 3, alineja me nr. 3 bëhet aline me nr. 4, alineja me nr. 4 bëhet aline me nr. 5, alineja me nr. 5 bëhet aline me nr. 6, alineja me nr. 6 bëhet aline me nr. 7, alineja me nr. 7 bëhet aline me nr. 8, alineja me nr. 8 bëhet aline me nr. 9.

Neni 3

Neni 7 shlyhet, ndërsa shtohen dy nene të rij pas neni 6 edhe atë

neni 7 – **Departamenti për çështje të përgjithshme dhe juridiko-normative i kryen detyrat që kanë të bëjnë me:**

- Ndjekjen dhe studimin e ligjeve dhe akteve tjera nga sfera e vetëqeverisjes lokale dhe zbatimin e tyre si dhe përgatitjen e mendimeve ndaj të njëjtave;
- Përgatitjen e akteve të veçanta dhe të përgjithshme nën kompetencën e Këshillit të komunës dhe prefekti nga sfera kompetente në përputhje me ligjin;
- Pranimit dhe verifikimi i librave protokollare, disponimin me dokumentet e komunës dhe ruajtjen deri në asgjësimin e tyre, respektivisht dorëzimin deri te Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë;
- Ndihmë profesionale në përgatitjen dhe realizimin e seancave të Këshillit dhe organeve të punës së Këshillit,

- Përgatiten e konkluzave, mendimeve, raporteve dhe llojeve tjera të materialeve për gjendjet në çështjet juridike që bëhen në komunë;
- Përfaqësimin e komunës para gjykatave dhe para organeve dhe institucioneve tjera kompetente;
- Ndjekja e rregullave nga sfera e punës arkivore dhe në zyrë;
- Mbajtjen e librit për shenja arkivore dhe libra për evidencë arkivore;
- Arkivim periodik i dokumentacionit komunal sipas afatit ligjor për ruajtjen e tij në arkivin e komunës;
- Pranimin dhe regjistrimin në librat e protokollit dokumentet e komunës dhe ruajtjen deri në asgjësimin e tyre, respektivisht deri në dorëzimin e tyre në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë;
- Propozimi dhe realizimi i strategjisë për futjen e sistemit informativ në komunë;
- Çështje për përkthim dhe lektorime dhe sigurimin e përkthimit gojor, të shkruara, simultane për nevojat e prefektit të komunës dhe administratës komunale;
- Kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes civile (në sferën e mbrojtjes dhe shpëtimit të qytetarëve dhe të mirave materiale nga rrënimet luftarake dhe fatkeqësive elementare dhe fatkeqësive tjera dhe nga pasojat e shkaktuara nga ata);
- Ndjekje dhe shqyrtimi nevojave për furnizime në komunë;
- Përgatitjen e planit vjetor për furnizime publike dhe realizimin e tij;
- Ndihmë profesionale dhe teknike Komisionit për furnizime publike dhe mbajtjen e evidencës dhe dokumentacionit në lidhje me furnizimet publike;
- Informimin e shfrytëzuesve të shërbimeve për realizimin më të lehtë të të drejtave të tyre;
- Çështje për parkun e automjeteve dhe çështje tjera teknike (mirëmbajtjen e higjienës dhe dorëzimin e postës);
- Çështje ndërlidhëse;
- Dhe çështje tjera që do t'i jepet nën kompetencë në pajtim me ligjet dhe aktet tjera.

Neni 7-a

Departamenti për veprimtari publike i kryen detyrat që kanë të bëjnë me:

- Ndjekjen e gjendjes në sferat e arsimit (parashkollor, fillor dhe të mesëm), kulturës, sportit dhe rekreacionit, mbrojtjen sociale, të fëmijëve dhe mbrojtjen shëndetësore në kuadër të kornizave ligjore;
- Ndjekja e rregulloreve nën kompetencën e vetëqeverisjes komunale dhe jep mendime nga këto sfera;
- Propozimi i masave dhe aktiviteteve që pushteti lokal duhet t'i merr në sferat e arsimit (parashkollor, fillor dhe të mesëm), kulturës, sportit dhe rekreacionit, mbrojtjen sociale, të fëmijëve dhe mbrojtjen shëndetësore në kuadër të kornizave ligjore;
- Koordinimi i punëve ndërmjet vetëqeverisjes lokale dhe shëndetësisë primare, arsimit, kulturës, mbrojtjes sociale dhe veprimtarive tjera publike të parapara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale,
- Dhe çështje tjera që do t'i jepet nën kompetencë në pajtim me ligjet dhe aktet tjera.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në Buletinin zyrtar të komunës së Dollnenit dhe do të zbatohet pas pëlqimit të marrur nga Agjensioni për Administratë:

Kryetari i komunës së Dollnenit
Husein Hasanoviq

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit", nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

për miratimin e Programeve Vjetore për punë në vitin shkollor 2014/15 shkollat fillore në komunën e Dollnenit

1. Shpallet vendimi për miratimin e Programeve Vjetore për punë në vitin shkollor 2014/15 shkollat fillore në komunën e Dollnenit me nr. 07-1141/3 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 15.08.2014.

2. Konkluzo do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-1501/2
15.09.2014

Prefekti
D-r Boshe Millosheski
Dollnen

Në bazë të nenit 35, pika 5 nga Ligji për Arsim Fillor ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 103/08) dhe nenit 28, paragrafi 1, alineja 44 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini zyrtar i komunës së Dollnenit", nr. 08/05) Këshilli i komunës së Dollnenit në seancën e tij të njëzetentë dhe mbajtur më 15.08.2014 e solli këtë:

V E N D I M

për miratimin e Programeve Vjetore për punë në vitin shkollor 2014/15 shkollat fillore SHF "Peco Daskallot"- Dollnen, SHF "Ismail Qemali"- Cërnilishtë, SHF "Liria" - Zhitoshe, SHF "Mirçe Acev"- Llazhan, SHF "Vera Ciriviri - Trena"- Debresht, SHF "Gjorçe Petrov"- Ropotovë dhe SHF "Pero Toshev"- Dupjaçan-Desovë

Neni 1

Programet Vjetore për punë për vitin shkollor 2014/15 të përgatitura nga ana e shkollave fillore SHF "Peco Daskallot"- Dollnen, SHF "Ismail Qemali"- Cërnilishtë, SHF "Liria" - Zhitoshe, SHF "Mirçe Acev"- Llazhan, SHF "Vera Ciriviri - Trena"- Debresht, SHF "Gjorçe Petrov"- Ropotovë dhe SHF "Pero Toshev"- Dupjaçan-Desovë u pranuan nga ana e Këshillit të komunës dhe urdhërohen shkollat e përmendura që t'i zbatojnë të njëjtat në vitin shkollor 2014/15.

Neni 2

Programet Vjetore për punë në vitin shkollor 2014/15 i parashikojnë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe aktivitetet për zhvillimin e mësimin për vitin shkollor 2014/15.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi nga dita e sjelljes së tij dhe i njëjti do të shpallet në Buletinin zyrtar të komunës së Dollnenit.

Kryetari i komunës së Dollnenit
Husein Hasanović

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit", nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

Për anulimin e Vendimit me nr. 07-1272/3 nga 15.08.2014 për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në buxhetin e komunës së Doillnenit për vitin 2014

1. Shpallet vendimi për anulimin e Vendimit me nr. 07-1272/3 nga 15.08.2014 për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në buxhetin e komunës së Doillnenit për vitin 2014 me nr. . 07-1141/4 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 15.08.2014.

2. Konkluzo do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-1501/3
15.09.2014

Prefekti
D-r Boshe Millosheski
Dollnen

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, alineja 15 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 5/02)

dhe nëpajtim meccenin 28, paragrafi 1, alineja 43 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini zyrtar i komunës së Dollnenit" nr. 08/05) Këshilli i komunës në seancën e mbajtur më 09.09.2014 e solli këtë :

V E N D I M

për anulimin e Vendimit me nr. 07-1272/3 nga 15.08.2014 për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në buxhetin e komunës së Doillnenit për vitin 2014

Neni 1

Me sjelljen e vendimit me nr. 07-1272/3 nga 15.08.2014 për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në buxhetin e komunës së Dollnenit për vitin 2014 është bërë gabim teknik në tekstin e Vendimit, i cili nuk mund të pranohet nga ana e Ministrisë për Financa dhe nga ata shkaqe i njëjti anulohet.

Neni 2

Për zbatimin dhe përmbartimin e buxhetit të komunës së Dollnenit ka nevojë nga sjellja e vendimit të ri për të anuluarin, i cili do të jetë me tregues të saktë dhe i pranuar nga ana e Ministrisë për Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi me sjelljen e tij dhe i njëjti do të shpallet në Buletinin zyrtar të komunës së Dollnenit.

Kryetari i komunës së Dollnenit
Husein Hasanović

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit", nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e komunës së Dollnenit për vitin 2014

1. Shpallet vendimi për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e komunës së Dollnenit për vitin 2014 me nr. 07-1141/5 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 15.08.2014.

2. Konkluzo do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-1501/4
15.09.2014

Prefekti
D-r Boshe Millosheski
Dollnen

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 5/2002) e në lidhje me nenin 34 nga Ligji për Buxhetin ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 64/2008) sillet ky:

V E N D I M

për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës së Dollnenit për vitin 2014

Neni 1

Me këtë vendim bëhet zgjerimi dhe ndryshimi i shpërndarjes së mjeteve në buxhetin e komunës së Dollnenit për vitin 2014 në mënyrën vijuese:

1. Shpallet vendim për zgjerimin dhe ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve të Buxhetit të komunës së Dollnenit për vitin 2014 në mënyrën vijuese:

Programi dhe emërimi i nënprogramit	Nënparagrafi dhe përshkrimi i nënparagrafit	Buxheti	Vetëfinansim	Dotacione	Donacione	Kredi
D00 PREFEKTI						
427110	punësime të përkohshme	80.000	0	0	0	0
426990	harxhime tjera operative	-80.000	0	0	0	0
F10	PLANIFIKIM URBANISTIK					
482910	Përgatitja e projekteve duke përfshirë dizajnimin e tjerëve	1.000.000	0	0	0	0

GD0 PROJEKTE PËR EFIKASITET ENERGJETIK

481230 rikonstruimi i objekteve afariste	-70.000	0	0	0	0
JG0 NDËRTIMI I SISTEMIT TË UJËSJELLËSIT					
482720 Ndërtimi i kapaciteteve për ujësjelljellës	1.000.000	0	0	0	0
K40 MANIFESTIME KULTURORE DHE KRIJIMTARI					
426990 harxhime tjera operative	70.000	0	0	0	0
N10 ARSIMI FILLOR					
N10 ARSIMI FILLOR					
425990 Shërbime tjera kontraktuese	-30.000	0	0	0	0
425760 shërbime transporti në arsim	0	0	-60.000	0	0
426990 harxhime tjera operative	0	0	60.000	0	0
423710 mjete për mirëmbajtjen e higjienës	-20.000	0	0	0	0
427110 punësime të përkohshme	62.000	0	0	0	0
425250 sigurimi i patundshmërive dhe të drejtave	-14.000	0	0	0	0
426990 harxhime tjera operative	-28.000	0	0	0	0

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Buletin zyrtar të komunës së Dollnenit dhe bëhet pjesë përbërëse e Buxhetit të komunës së Dollnenit për vitin 2014.

Kryetari i komunës së Dollnenit
Husein Hasanoviq

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit", nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

për transport linjor komunal për udhëtarë në komunën e Dollnenit

1. Shpallet vendimi për transport linjor komunal për udhëtarë në komunën e Dollnenit me nr. 07-1141/6 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 15.08.2014.

2. Konkluzë do të shpallet në Buletin Zyrtar të komunës së Dollnenit.

Nr. 08-1501/5
15.09.2014

Prefekti
D-r Boshe Millosheski
Dollnen

Në bazë të nenit 22 për Transport në trafikun rrugor ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 68/2004; 127/2006; 114/2009; 83/2010; 140/2010; 17/2011, 53/2011, 6/2012, 23/2013, 120/13, 163/13, 187/13, 42/2014 и 112/14) dhe nenit 28 nga Statuti i komunës së Dollnenit në seancën e mbajtur më 09.09.2014 e solli këtë:

V E N D I M

Për transport linjor komunal për udhëtarë në komunën e Dollnenit

Neni 1

Me këtë vendim rregullohet transporti linjor komunal dhe transporti i veçantë linjor i udhëtarëve në komunën e Dollnenit.

Neni 2

1) Transporti linjor për udhëtarë në komunën e Dollnenit organizohet në mënyrën vijuese:

- Me caktimin e rrjetit të vetëm të linjave;
- Me përcaktimin e rendit të vetëm vozitës, mënyrën e shpalljes së tij, mirëmbajtjen dhe ndrimin e tij,
- Mënyrën e organizimit dhe kontrollit të qarkullimit të autobusëve dhe linjave si dhe evidencën e tyre,
- Sistemin tarifor për pagesë dhe mënyrën e kontrollit të pagesës,
- Lokacioni i linjave të autobusit, terminalët, vendet për kthim, dhe vend-ndalimet si dhe procedurat për ndrimin e tyre,

- Ndërtimi, shënim, pajisja, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i terminalëve të autobusëve, vendeve për kthim dhe vend-ndalimeve,
- Caktimi i relacionit dhe vendit për transport me kombi automjete me së paku nëntë ulëse (8+1),
- Krite për mënyrën dhe procedurën e lëshimit dhe marrjes së lejes për kryerjen e transportit linjor komunal dhe shpërndarjen e linjave operatorëve për transport linjor dhe transportin në komunë.

1.

2.

I Rrjeti i linjave në përputhje me nevojat e komunës së Dollnenit, mënyra e mbajtjes dhe frekuentimi i të njëjtave

Neni 3

Rrjetin e linjave komunale e përcakton Këshilli i komunës së Dollnenit me propozimi të operatorëve për transport, bashkësive lokale dhe personave tjerë fizikë, të cilat mund të iniciojnë hapjen e linjave të reja, të cilat nuk janë të përfshirë në rrjetin e linjave komunale.

Neni 4

Linja në transportin linjor komunal të udhëtarëve ka numrin dhe emërimin e saj.

Emërimi i linjës shënohet me emrin e vend-ndaljes fillestare dhe fundore.

Numri dhe emërimi i linjës vihet në automjetin.

Neni 5

Rrjeti i linjave në komunën e Dollnenit është si vijon:

Linja 1: Gostirazh-Cërnilishtë-Kostinc-Ropotvë, Zhitoshe-Gostirazh

Linja 2: Sekirc-Peshtalevë-Ropotovë-Sekirc.

Linja 3: Zapolzhan, Novosellan, Dollnen-Zapolzhan.

Linja 4: Llokven-Dollno Zhitoshe-Zhitoshe-Llokven.

Linja 5: Debresht-Llazhan-Zhitoshe-Debresht.

Linja 6: Sredorek-Vrance-Kutleshevë-Bellopole-Dollnen-Sredorek.

Neni 6

Transporti linjor komunal i udhëtarëve kryhet me autobus të vetëm, të cilat i plotësojnë standardet teknike për kryerjen e transportit të udhëtarëve.

Me përjashtim atje ku kushtet teknike dhe të eksploatimit të rrugës nuk e mundësojnë atë, transporti mund të kryhet edhe me automjet kombi me së paku 9 ulëse (8+1), të cilat i plotësojnë standardet teknike për transportin e udhëtarëve.

Neni 7

Ngjyra e autobusëve është e lirë (sipas dëshirës)

Neni 8

Numri dhe emërtimi i linjës së autobusit është i shënuar në bazë të bardhë me shkronja të zeza të shtypit në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik dhe në gjuhën e bashkësive, të cilat janë mbi 20% nga numri i popullatës së komunës së Dollnenit.

Numri dhe emërtimi i linjës së autobusit vendohen në pjesën e brendshme, mbi xhamin e parë (parafangon), në hapësirën e bërë për shpallje dhe në anën e djathtë anash, afër derës së parë dhe të pasme me dimension të përkthuar dhe të ndriçuar.

Neni 9

Autobusët në pjesën e brendshme të automjetit duhet të kenë mbishkrime dhe shenjë për informimin e udhëtarëve edhe atë:

1. Numrin e ulëseve të regjistruara për t'u ulur dhe për të qëndruar,
2. Mbishkrim dhe shenjë "Ndalohet pirja e duhanit",
3. Mbishkrim me përmbajtje "ulëset paraprakisht janë të dedikuara për invalidë, nëna me fëmijë të vegjël dhe njerëz të moshuar,
4. Mbishkrim me pasqyrë skematike të vend-ndaljes fillestare, fundor dhe atyre gjatë udhëtimit në linjë.

Mbishkrimet janë të shkruara në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik dhe në gjuhën e bashkësive, të cilat janë mbi 20% nga numri i popullatës së komunës së Dollnenit.

II. Rendi i udhëtimit, mënyra e paraqitjes së tij, mirëmbajtja dhe ndrimi në pajtim me nevojat e komunës së Dollnenit

Neni 10

Rendi i udhëtimit përmban: numrin dhe emërtimin e linjës, vend-ndalimet e fillimit dhe mbarimit, koha e ardhjes dhe shkuarjes së automjeteve të vend-ndalimeve të fillimit dhe mbarimit dhe afati i vlefshmërisë.

Neni 11

Rendin e udhëtimit e regjistron prefekti i komunës.

Për orarin e regjistruar të vozitjes operatorit për transport i lëshohet vendim (leje)

Rendi i udhëtimit dhe linja regjistrohen në emër të operatorit për transport dhe nuk mund të bëjë me operator për transport tjetër.

Rendi i udhëtimit për shkak të realizimit parashtrohet të çdo operator për transport.

Rendin e udhëtimit operatorit për transport e shfaq në vetë automjetin.

Neni 12

Operatori për transporti është i obliguar linjat t'i mbajë në pajtim me rendin e regjistruar për vozitje.

Gjatë realizimit të rendit të udhëtimit në çdo linjë operatori për transport është i detyruar të ndalet vetëm në vend-ndalimet e autobusëve të përcaktuara me këtë vendim.

Neni 13

Gjatë vozitjes sipas rendit të udhëtimit, transporti në linjë të caktuar mundet përkohësisht të jetë i ndalur për shkak të ndërprerjes së trafikut nga fuqitë më të larta.

Operator për transport është i detyruar për ndaljen e përkohshme të linjës t'a informojë menjëherë komunën.

Operatori për transport nëse nuk është në mundësi që rregullisht ta mbajë linjën është i detyruar që së paku 7 ditë para refuzimit të mbajtjes së linjës ta informojë komunën.

Neni 14

Gjatë kryerjes së linjës komunale për transport të udhëtarëve operatori për transport është i detyruar në autobus të ketë licencë dhe orar vozitjeje të regjistruar në origjinal ose kopje e verifikuar nga organi, i cili e ka të lëshuar.

Neni 15

Kontrollimin e qarkullimit të autobusëve dhe linjave e bën pronari nëpërmjet të shërbimit të tij për kontrollim si dhe nga inspektori i autorizuar për trafikun rrugor në komunën e Dollnenit.

IV. Sistemi tarifor dhe sistemi i pagesës

Neni 16

Në transportin linjor komunal caktohet një sistem tarifor të vetëm sipas kilometrit të kaluar.

Neni 17

Çmimi i transportit dhe shërbimeve në transportin linjor komunal formohet në bazë të metodologjisë së harxhimeve të pranuarra shoqërore, me të cilat sigurohet reproduksioni i thjeshtë në kryerjen e veprimtarisë.

Neni 18

Transporti linjor komunal në komunën e Dollnenit caktohet me tarifën vijuese:

Nga 0 deri në 3 km	40.00 denarë
Nga 3 deri në 5 km	50.00 denarë
Nga 5 deri në 10 km	60.00 denarë
Nga 10 deri në 15 km	70.00 denarë
Nga 15 deri në 20 km	80.00 denarë
Nga 20 deri në 25 km	90.00 denarë
Nga 25 deri në 30 km	100.00 denarë
Mbi 30 km	100.00 denarë + 5 denarë për çdo kilometër të kaluar.

Neni 19

Tarifa e çmimeve është e përcaktuar me çmimin e vlefshëm të derivateve të naftës në ditën e sjelljes së tarifës.

Deri në ndryshimin e çmimit mund të vijë gjatë çdo zmadhimi ose zvogëlimi të çmimit të caktuar nga ana e Komisionit Rregullator për Energjetikët i Republikës së Maqedonisë për mbi 10% gjatë së cilës çmimet e transportit mund të ndryshohen më së shumti për 10%.

Neni 20

Tarifën e sjell Këshilli i komunës së Dollnenit me propozim të operatorëve për transport dhe është pjesë përbërëse e Vendimit për transportin linjor komunal për udhëtarë në komunën e Dollnenit.

Neni 21

Operatori për transport në transportin linjor komunal është i detyruar çdo udhëtar t'i jep biletë.

Bileta e vozitjes përmban numrin serial, emërtimin e operatorit për transport, çmimin e transportit dhe llogarinë fiskale.

Neni 22

Për shërbimet e transportit operatori për transport mund të lëshojë edhe bileta të parapaguara (njëditore, treditore, javore, mujore dhe vjetore).

V. Mënyra e sigurimit të sigurisë të operatorit për transport nga aspekti i ndjekjes së nevojave të komunës dhe kapaciteteve e nevojshme operator për transporte

Neni 23

Sigurinë në kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe sigurimin e funksionimit të sistemit si dhe tërësinë tekniko-teknologjike, si dhe kryerjen e përhershme dhe pa ndërprerje të transportit e siguron operatori për transport.

Neni 24

Nëse operatori për transport nuk mund ta kryej transportin linjor komunal për udhëtarë, për të cilin ka marrë licencë është i detyruar deri në komunën e Dollnenit të parashtrojë kërkesë për lejimin e ndërprerjes së përkohshme ose të përhershme të transportit.

Neni 25

Transporti mundet përkohësisht të ndërpritet më së shumti deri në tre muaj gjatë një viti ose të ndërpritet për përgjithmonë në bazë të vendimit të lëshuar nga ana e prefektit të komunës së Dollnenit.

Neni 26

Kontrata do të vazhdohet nga ana e dhënësit të lejes për periudhën e ardhshme nëse operatori për transport linjat i ka mbajtur në pajtim me rregullat pozitive ligjore në fuqi dhe nevojave të komunës nëse nuk ndodhin ndryshime tjera ligjore në transportin linjor komunal për udhëtarë.

VI Lokacioni i vend-ndaljeve të autobusëve dhe procedura për ndryshimin e tyre

Neni 27

Vend-ndaljet e autobusëve në territorin e komunës së Dollnenit i përcakton Këshilli i komunës.

Pasqyra grafike e vend-ndaljeve të autobusëve është pjesë përbërëse këtij vendimi.

Neni 28

Organi kompetent i komunës, Bashkësitë Lokale dhe operatori për transport mund t'i propozojnë Këshillit të komunës së Dollnenit hapjen e linjave të reja, ndërprerjen ose dislokimin e vend-ndaljeve të autobusëve nëse ajo është në interes për organizimin më të mirë të organizimit të transportit dhe sigurinë e transportit.

VII. Ndërtimi, shënim, pajisja, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i vend-ndaljeve të autobusëve.

Neni 29

Ndërtimin, shënimin, pajisjen, mirëmbajtjen dhe mënyrën e shfrytëzimit të vend-ndaljeve të autobusëve në transportin e linjave të autobusëve për udhëtarët e kryen komuna e Dollnenit.

Neni 30

Vend-ndalimet e autobusëve shënohen me tabela.

Tabela nga paragrafi 1 i këtij neni përmban: mbishkrim në vend-ndalimin e autobusëve, kthesë si dhe mbishkrime tjera që shërbejnë për informimin e udhëtarëve (orari i vozitjes dhe njësoj).

Pasqyra nga paragrafi 1 i këtij neni shfaqet në vend të dukshëm në vetë vend-ndalimin e autobusëve.

Sipërfaqja për vozitje e vend-ndalimit të autobusëve dhe kthesa e dedikuar për ndaljen e autobusëve shënohet me

shenjë standarde **BUS** me shkronjë të verdhë dhe me alfabet latin.

Neni 31

Pajisja e vend-ndalimeve të autobusëve nën kushte dhe në pajtim me komunën mund të përdoret për reklamë, propagandë dhe informime.

Neni 32

Pajisjen e vend-ndaljeve të autobusëve e bën komuna.

Neni 33

Vend-ndalimet e autobusëve duhet të kenë:

- 1) Strehë për mbrojtjen e udhëtarëve nga ndikimet atmosferike e përpunuar nga materiali i përshtatshëm,
 - Numrin dhe emërtimin e linjave që nisin, vijjnë dhe kalojnë dhe
 - Pasqyrë skematike e rrjetit të linjave.
- 2) Vend-ndalimet e autobusëve mund të kenë:
 - Pajisje urbane
 - Pano reklamuese dhe
 - Përmbajtje tjera.

Neni 34

Operatorët për transport marrin pjesë në mbulimin e harxhimeve për përpunimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të pajisjes urbane me përqindjen me të cilën marrin pjesë në realizimin e itinerarit për vozitje në rrjetin e linjave.

VII. caktimi i relacionit dhe venit për transport me automjet kombi me më së shumti 9 ulëse (8+1)

Neni 35

Në vend-ndalimet, në të cilat komuna e Dollnenit ka të organizuar transport linjor për udhëtarë, transporti mund të kryhet me kombi automjet (8+1).

Neni 36

Operatori i transportit me automjet kombi do të bëjë transportin e udhëtarëve në relacionin nga vendbanimet ku nuk është i organizuar transporti linjor komunal për udhëtarë deri te dhe nga vend-ndalimi më i afërt i autobusëve ose kthesa.

XI. Kriteria për shpërndarjen e linjave operatorëve të transportit në transportin linjor komunal

Neni 37

Transportin linjor komunal për udhëtarë në territorin e komunës së Dollnenit mund ta kryejnë operatorët e transportit që do të fitojnë licencë për kryerjen e transportit të këtyllë, ekstrakt licence, leje, urdhëresë udhëtimi në origjinal dhe orarin e regjistruar të udhëtimit në origjinal.

- Licenca për transportin linjor të udhëtarëve në territorin e komunës së Dollnenit, ekstraktin e licencës dhe lejen e lëshon prefekti i komunës së Dollnenit dhe ka afatin e vlefshmërisë deri në 5 vite.
- Harxhimet e bëra në lidhje me lëshimin e licencave dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm për kryerjen e transportit në trafikun rrugor në komunë i bart operatori i transportit.

Neni 38

Për marrjen e licencës dhe lejes për kryerjen e transportit linjor komunal për udhëtarë, përkrah kushteve tjera për kryerjen e veprimtarisë, operatori i transportit duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

- Të jetë i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, të ketë të regjistruar veprimtari prioritarë/ shifër kryesore e të ardhurave për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe mallrave në trafikun rrugor;
- Të ketë nën pronësi një ose më tepër automjete, të cilat i plotësojnë kushtet tekniko-eksplotuese për transport;
- Të ketë të punësuar vozitës (shoferë) varësisht nga numri i automjeteve (autobusë dhe kombi automjete 8+1) që i plotësojnë kushtet e parapara me rregullat për siguri në trafikun rrugor;
- Të ketë gjendje solide financiare;
- Të mos jetë në fuqi aktvendim gjyqësor i plotfuqishëm për vepër penale kundër pronës, ekonomisë ose sigurisë në trafikun publik;

- Të ketë kapacitetin për parkim dhe mirëmbajtjen e autobusëve ose provë për shfrytëzimin e kapacitetit të tillë me afat vlefshmërie më së paku prej 4 viteve;
- Në automjetin për kryerjen e transportit linjor komunal të udhëtarëve të ketë të pajisur aparat fiskal;

Neni 39

Prefekti i komunës së Dollnenit mund t'i ja marrë licencën dhe lejen për transportin linor komunal operatorit të transportit nëse vërteton se:

- operatori i transportit nuk i plotëson disa nga kushtet e nenit 38 të këtij vendimi për marrjen e licencës,
- kryen transportin në kundërshtim me licencën e lëshuar,
- operatori i transportit pushon me kryerjen e veprimtarisë në trafikun rrugor.

Neni 40

Shpërndarjen e linjave, nëse ka më tepër operatorë të transportit e bën Komisioni tre anëtarësh i formuar nga ana e prefektit të komunës së Dollnenit, i cili do të mbajë llogari për:

- përparësi për shpërndarjen e linjave të kenë operatorë të transportit me seli në vendin e nisjes;
- ka vjetërsi mesatare më të ulët të automjeteve (autobusë dhe kombi automjete 8+1);
- ka kuadër përkatës profesional për kryerjen kualitative të transportit si dhe për mirëmbajtjen kualitative të dhe riparimin e autobusëve.

Neni 41

Nëse ka më tepër operatorë transporti, të cilat e kanë selinë në vendin e nisjes, në atë rast përparësi ka operatori i transportit, i cili ka gjendje solide financiare dhe dëshmohet nëpërmjet dokumentacionit vijues:

- të dhëna të regjistruara për kapitalin kryesor dhe rezerva në bilancin për gjendjen e viti paraprak;
- garanci e lëshuar nga banka ose Shoqatë Sigurie me afatin e vlefshmërisë identike me afatin e vlefshmërisë së licencës.

X. Mbikëqyrje

Neni 42

Mbikëqyrjen inspektive në zbatimin e dispozitave të këtij Vendimi e bën inspektor i autorizuar për trafik rrugor në komunën e Dollnenit.

Neni 43

Operatorët e transportit në transportin linjor komunal janë të detyruar inspektorit komunal për trafik rrugor t'i japin informata të nevojshme dhe t'i ja lënë në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe dokumentacionin tjetër.

XI. Dispozitat ndëshkimore

Neni 44

Për mosrespektimin e këtij vendimi zbatohen dispozitat ndëshkimore të parapara me Ligjin për Transport në trafikun rrugor.

XII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 45

Operatorët e transportit, të cilat kryejnë transportin e udhëtarëve në trafikun komunal janë të detyruar t'a harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij Vendimi në afat prej 3 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të të njëjtit.

Neni 46

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Buletin zyrtar të komunës së Dollnenit".

Kryetari i komunës së Dollnenit
Husein Hasanoviq

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit", nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

për dekretin për caktimin e masave dhe kritereve për shpërndarjen e mjeteve nga bllok dotacioni për shkollat fillore të komunës së Dollnenit për vitin 2014

1. Shpallet vendimi për dekretin për caktimin e masave dhe kritereve për shpërndarjen e mjeteve nga bllok dotacioni për shkollat fillore të komunës së Dollnenit për vitin 2014 me nr. 07-1141/7 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 15.08.2014.

2. Konkluzë do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-1501/6
15.09.2014

Prefekti
D-r Boshe Millosheski
Dollnen

D E K R E T

për caktimin e masave dhe kritereve për shpërndarjen e mjeteve nga bllok dotacioni për shkollat fillore të komunës së Dollnenit për vitin 2014

Neni 1

Me këtë dekret parashikohet metodologjia për caktimin e masave dhe kritereve për shpërndarjen e mjeteve nga bllok dotacioni për shkollat fillore të komunës së Dollnenit për vitin 2014.

Neni 2

Në pajtim me buxhetin e komunës së Dollnenit për vitin 2014, në pjesën e veçantë për Arsimin Fillor do të kryhet financimi i kompetencave të bartura në shkollat fillore.

Neni 3

Mjetet e përcaktuara në neni 2 të këtij Dekreti u shpërndahen shkollave fillore, të cilave u janë të bartura të drejtat e themelimit në pajtim me Ligjin për Arsim Fillor ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 103/08).

Neni 4

Masa dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve nga bllok dotacionet në shkollat fillore kryhet sipas planit të parashtruar dhe nevojave për çdo muaj, por duke u bazuar në numrin e nxënësve dhe kuadrin arsimor në shkollë.

Neni 5

Shpërndarja e mjeteve të caktuara si bllok dotacion shfrytëzohet për punë në shkollat fillore edhe atë për: rroga, qira dhe kompensime për të punësuarit, mallra dhe shërbime, shërbime komunale, nxehje, rrymë elektrike, komunikacion dhe transport, materiale për zyrë, pajisje dhe inventar të vogël, mjete për mirëmbajtjen e higjienës, mirëmbajtje aktuale, shërbime tjera kontrate, harxhime tjera operative dhe transportin e nxënësve.

Neni 6

Mjetet e caktuara nga buxheti i komunës së Dollnenit në muaj ose sipas dinamikës ashtu si vijnë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë barten në shkollat fillore për harxhime aktuale.

Neni 8

Ky Dekret hyn në fuqi me ditën e shpalljes në Buletinin zyrtar të komunës së Dollnenit.

Kryetari i komunës së Dollnenit
Husein Hasanoviq
